

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objkti i Procedures: “Mirëmbajtje dhe perditësime të sistemeve Multimediale dhe Ambjenteve të punës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50312310-1
Mirëmbajtje e pajisjeve të rrjetit të të dhënave.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **29,899,867** (Njzet e nente milion e tetetëqind e nentëdhjetë e nente mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
- **298,432** (Dyqind e nentëdhjetë e tete mijë e katërqind e tridhjetë e dy) euro pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në piken 1 të nenit 6 të ligjit 16/2024, “për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në VKM nr. 498, dt. 01.08.2024, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur që kjo procedure të mos jete në lotë sipas arsytimit të mëposhtëm:

Objekt i kësaj procedure prokurimi është Garancia për mirëmbajtje të Software për menaxhimin e videowall FRIENDLYWAY COMPOSER 9 dhe Videowall me permasa 309 cm X 176cm Dahua - LS460UCM 46", **Furnizim Vendosje** Kavo LAN Cat.6, Patch Panel Cat.6 24 Port, Cable Manaxher, Switch i Menaxhueshëm me 48 porta PoE+ Sistem Videokonference Videowall për Sallen e Mbledhjeve kati 1 Mbajtëse Monitori për Videowall dhe Shtirje Kabllosh për Salla Mbledhjes, Pershtatje e pozicioneve të punës me prize DATA, Pershtatje e pozicioneve të punës me prize Elektrike. Gjithashtu një element kryesor është dhe Garanci për Mirëmbajtjen të Software për menaxhimin e videowall FRIENDLYWAY COMPOSER 9 dhe Videowall me permasa 309cm X 176cm Dahua - LS460UCM 46".

Per sa mesiper kjo procedure nuk mund të ndahet në lotë pasi nuk mundet që disa operatore të koordinohen në kohe reale për të dhënë të njëjtin shërbim dhe në fund të arrijnë në kohe reale rezultate të kerkuara nga AK gjithashtu të garantojnë dhe mirëmbajtjen me vete.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, në ligjin nr 16/2024 “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, për prokurimin publik”, në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, në nenin 11 të Vendimit nr. 498 datë 01.08.2024.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe marrë persiper çdo rrezik që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 14,850,000 (Katërmbëdhjetë milion e teteqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “e hapur shërbime – mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma” a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

1. dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit) është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që

operojnë ne treg si dhe per rritur numrin e konkurrentëve në kete procedure eshte gjykuar qe vlera e xhiros se kerkuar te jete minimalisht sa 50% e vleres se parashikuar te kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se:” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3 (tre) viteve te fundit 2021, 2022, 2023. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu te jene të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te nenit 41, pika” c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore “përcaktohet se:” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit

paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 11,900,000 (Njembëdhjete milion e nentëqind mijë) leke pa TVSH.

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshëm) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do jete realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf për kryerjen e të gjitha shërbimeve objekt kontrate, stafi të jete i vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit, si më poshtë:

1. Te pakten 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per Menaxhim Projektsh PMP ose ekuivalente
2. Te pakten 1 (nje) Inxhinier Mekatronik / Elektrik ose Ekuivalente.
3. Te pakten 1 (nje) specialist te çertifikuar CISM (Certified Information Security Manager) ose ekuivalente
4. Te pakten 2 (Dy) Inxhinier Elektronik / Telekomunikacioni ose ekuivalente.
5. Te pakten 2 (dy) specialist te çertifikuar ne nivelin Professional per VideoWall ose ekuivalente per sistemin VideoWall Dahua
6. Te pakten 2 (dy) specialist te çertifikuar per software FRIENDLYWAY DIGITAL SIGNATURE ose ekuivalente te VideoWall

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilën nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mësipërme të ekspertizes si dhe numri i personelit të certifikuar, janë kryer në bazë të

*komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialisteve. Diplomimi i punonjësve në degët Mekatronike/Elektrike ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi ka si qëllim të përgjithshëm Garancinë për mirembajtje të Software për menaxhimin e videowall FRIENDLYWAY COMPOSER 9 dhe Videowall me permasa 309 cm X 176cm Dahua - LS460UCM 46", **Furnizim Vendosje** Kavo LAN Cat.6, Pach Panel Cat.6 24 Port, Cable Manaxher, Switch i Menaxhueshëm me 48 porta PoE+ Sistem Videokonference Videowall për Sallen e Mbledhjeve kati 1 Mbajtëse Monitori për Videowall dhe Shtrirje Kabllorsh për Salla Mbledhëse, Pershtatje e pozicioneve të punës me prize DATA, Pershtatje e pozicioneve të punës me prize Elektrike.*

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave / etapave të zbatimit të kontratës, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë. Lloji i profesionit të inxhinierëve të kërkuar lidhet me natyrën e shërbimeve sipas zerave të preventivit.

Te pakten 1 (nje) Menaxher Projekti, kërkohej për të garantuar organizimin e njerëzve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

Te pakten 1 (nje) Inxhinier Mekatronik/ Elektrik ose Ekuivalente gjykohej se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës si furnizim+vendosje dhe rendesise se zgjidhjes së sakte teknologjike për instalimin e mbikëqyrjen e sistemeve të reja dhe integrimi i mundshëm me ato ekzistuese të AK, ku të gjitha këto duhet domosdoshmerisht të ndiqen nga te pakten 1 (nje) profesionist i kualifikuar inxhinierik mekatronik / elektrik nga fillimi (nenshkrimi i kontratës) deri në përfundim të saj, në mënyrë që të minimizohet në maksimum rrishtën e vendosjeve teknologjike të pasakta, duke pasur parasysh që përben një kompleksitet teknologjik më vete.

Te pakten 1 (nje) specialist i certifikuar CISM (Certified Information Security Manager) ose ekuivalente, duke qenë se pjesë e objektit është blerja e switch që do të vendosen dhe konfigurohen në datacenter të AK, është e nevojshme që OE të ketë një stafin e tij, të pakten 1 (nje) specialiste të certifikuar në nivel CISM (Certified Information Security Manager), duke garantuar AK për mos ndërprerje të shërbimit dhe vijueshmërinë e punës. Bejme sqarimin se certifikimet multinationale janë tepër të specializuara dhe të dedikuara, ndaj duhet të jenë të njëjta certifikimet e kërkuara nga AK. Kjo shërben për të tërhequr vëmendjen e operatorëve ekonomik që të jenë tepër të specializuar në certifikimet që do paraqesin bashkë me ofertën. Specialistet kërkohej për të implementuar, suportuar si dhe për të mirembajtur zgjidhjen, e cila është relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore.

Te pakten 2 (Dy) Inxhinier Elektronik / Telekomunikacioni ose ekuivalente gjykohej se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës si furnizim+vendosje dhe rendesise se zgjidhjes së sakte teknologjike për instalimin e mbikëqyrjen e sistemeve të reja dhe integrimi i mundshëm me ato ekzistuese të AK, ku të gjitha këto duhet

domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 2(dy) profesionist te kualifikuar inxhinjerik elektronik/telekomunikacion nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku vendosjeve teknologjike te pasakta.

Te pakten 2 (dy) specialist te çertifikuar ne nivelin Professional per VideoWall ose ekuivalente per sistemin VideoWall Dahua, gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise, kompleksitetit te realizimit te kontrates si furnizim+vendosje per sistemet VideoWall, rendesise qe ka instalimi i sakte dhe kompetent sipas udhezimeve te prodhuesve dhe integrimi i mundshem me ato ekzistuese te AK, ku te gjitha keto duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 2(dy) specialist te çertifikuar nga prodhuesi respektiv, nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku instalimeve teknologjike te pasakta;

Te pakten 2 (dy) specialist te çertifikuar per software FRIENDLYWAY DIGITAL SIGNATURE ose ekuivalente te VideoWall, gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise, kompleksitetit te realizimit te kontrates si mirembajtje e software FRIENDLYWAY DIGITAL SIGNATURE, rendesise qe kane konfigurimet e sakta dhe kompetente sipas udhezimeve te prodhuesve dhe integrimi i mundshem me ato ekzistuese te AK, ku te gjitha keto duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 2(dy) specialist te çertifikuar nga prodhuesi respektiv, nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku instalimeve teknologjike te pasakta

Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e shërbimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi, konkretisht duke mbuluar:

Garancine per mirembajtje te Software per menaxhimin e videowall FRIENDLYWAY COMPOSER 9 dhe Videowall me permasa 309 cm X 176 cm Dahua - LS460UCM 46", Furnizim Vendosje te Kavos LAN Cat. 6, Pach Panel Cat.6 24 Port, Cable Manaxher, Switch i Menaxhueshem me 48 porta PoE+ Sistem Videokonference Videowall per Sallen e Mbledhjeve kati 1 Mbajtese Monitori per Videowall dhe Shtrirje Kabllosh per Salla Mbledhjesh, Pershtatje e pozicioneve te punes me prize DATA, Pershtatje e pozicioneve te punes me prize Elektrike. Gjithashtu nje element kryesor eshte dhe Garanci per Mirembajtjen te Software per menaxhimin e videowall FRIENDLYWAY COMPOSER 9 dhe Videowall me permasa 309cm X 176cm Dahua - LS460UCM 46".

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe ISO 27001:2013 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme), ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente për menaxhimin e shërbimeve IT, ISO 50001:2018 ose ekuivalente për menaxhimin e energjise.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marre përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 27001:2013 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi i tyre të jete i verifikueshem.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise se informacionit, duke pasur me shume garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë

dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

Kërkesa Lidhur me çertifikimin ISO 50001:2018 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi të energjisë, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është i bazuar në produkte të transmetimit të energjisë pasive dhe aktive, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes elektrike.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim territorial nga Prodhuesi / Distributori i Autorizuar, ku të autorizohet operatori për të gjitha zërat e mallrave objekt i këtij prokurimi.

Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit të autorizuar të përfshijë të dhëna të plota dhe detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së Autorizimeve të kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë edhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së shërbimeve. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për Autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet, zgjerim në cilësi e performancë të disa prej sistemeve kryesore në zotërim nga Autoriteti Kontraktor, për blerjet e reja cilësore që zgjerojnë ato ekzistuese dhe upgrade (përmirësim) të sistemeve ekzistuese sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve e garancive të suportit, karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Termet e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.